



Datë: 06.08.2025
Numër Protokolli: 5330/2025

A.nr.1035/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1035/2025, të datës 30.05.2025, të parashtruar nga ankuesi M.L nga Prishtina, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike ‘*transferim si pasojë e ristrukturimit*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1035/2025, e datës 30.05.2025, të parashtruar nga ankuesi M.L.

A r s y e t i m

Ankuesi M.L (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 30.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.AAC/017-2025 me nr.protokolli 951 të datës 30.04.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimit i provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2012 mbante pozitën *Inspektor i Shërbimeve të Navigacionit Ajror* në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Tutje Kryeministri i Republikës së Kosovës, ka miratuar Rregulloren (AAC) Nr. 02/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil, ku sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje është paraparë edhe struktura organizative e AAC-së, si në vijim: *Struktura organizative funksionale dhe operative e AAC-së përbëhet nga: 1.1 Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm; 1.2 Divizioni i Operimeve Ajrore; 1.3 Divizioni i Vlefshmërisë Ajrore dhe Licencimit të Personelit; 1.4 Divizioni i Aerodromeve; 1.5 Divizioni i Shërbimeve të Navigacionit*

Ajror; 1.6 Divizioni i Standardizimit dhe Legjislacionit në Aviacion; 1.7 Divizioni i Rregullimit Ekonomik të Aviacionit dhe 1.8 Divizioni i Sigurisë dhe Cilësisë.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.03.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 228/2025, për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në Autoritetin e Aviacionit Civil. Komisioni i Ristrukturimit i Autoritetit të Aviacionit Civil më datë 18.04.2025, ka nxjerr raportin e punës me numër protokolli 859, përmes të cilit ka propozuar që ankuesi të sistemohet në pozitën *Udhëheqës i Divizionit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror*. Bazuar në këtë raport Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 30.04.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. AAC/017/2025 me të cilin ankuesin nga pozita aktuale “*Inspektor i Shërbimeve të Navigacionit Ajror*” transferohet në “*Inspektor i Shërbimeve të Navigacionit Ajror*” në Divizionin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.AAC/017-2025 të datës 30.04.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se ndaj Rregullores (AAC) Nr. 02/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil, është parashtruar padi fillimisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative e cila tani pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative është deleguar në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankuesin kërkon që përderisa rregullorja mbi bazë të të cilës është përfunduar procesi i ristrukturimit të shqyrtuar nga gjykata, procedura duhet pezulluar.

Bazuar në provat e lëndës, respektivisht emailit të datës 04.08.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme si organ që ka nxjerr Vendimin me Nr.AAC/017-2025 të datës 30.04.2025 të kontestuar nga ankuesi, i njëjti ka njoftuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pas pranimi të Aktgjykimit P.A.nr.07/2025 të Gjykatës Supreme, ka shfuqizuar të gjitha vendimet e ristrukturimit të AAC-së të nxjerra nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, duke qenë se transferimi i nëpunësve është bërë duke u bazuar në pozitën e përcaktuara në Rregulloren (AAC) Nr. 01/2025, e cila është shfuqizuar nga Gjykata Supreme përmes këtij Aktgjykimi.

Përkitazi me këtë duke qenë se Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 04.08.2025, ka nxjerr akt të ri respektivisht Vendim me Nr. AAC/025/2025, me të cilin është shfuqizuar Vendimi me Nr.AAC/017-2025 i datës 30.04.2025 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, atëherë, Kolegji mbi këto gjendje të rrethanave erdhi në përfundim së objekti i ankesës është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje për faktin që vendimi i kontestuar nga pala është shfuqizuar, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*, si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1035/2025, të datës 30.05.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1035/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit M.L;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.